

VENDIM
Nr.621, datë 21.9.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË ZYRËS
SË PËRMBARIMIT, KURBIN, NGA ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
GJYQËSOR, DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT NË MINISTRINË E
DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja c të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, të mjediseve të zyrës së përmbarimit, Kurbin, të përcaktuara në formularin nr.1, me numër rendor 4 dhe numër pronësie 4/305/1, sipas planimetrisë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e kësaj prone, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano